



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Nr. i referencës: 626-23-010-5-2-1

Me 14.06.2023
Mamushë

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (a) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-5039-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-010-5-2-1

II

I njëjti duhet të rishpallet sipas procedurave të prokurimit, pas afatit për ankesa.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 22.05.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “HAPJA E PUSIT NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-S NË MAMUSHË” me nr. të prokurimit: 626-23-5039-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-22-010-5-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë shkarkuar tetë (8) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin nuk e ka dorëzuar asnjëri prej tyre.

Në rastet kur pas hapjes së tenderit vërtetohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka pranuar asnjë ofertë, kërkohet që të anulohet procedura e prokurimit në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (a) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

